

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPLLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

**Punonjës Mbështetës në Terren, Drejtorja e Kontrollit të Terrenit (Kategoria klasa IX).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.34029/1, datë 28.09.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

**Kërkesat e posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm), *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zoterimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

**Punonjësi Mbështetës në Terren ka për detyrë si më poshtë:**

- Punonjësi Mbështetës në Terren varet direkt nga Përgjegjësi i Sektorit.
- Zbaton programin e punës sipas miratimit nga përgjegjësi i sektorit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.
- Merr pjesë në inspektim sipas grupeve të punës ndarë me urdhër të brendshëm sipas njërive të miratuara nga Kryeinspektori.
- Trajton ankesat e marra nga institucionet qëndrore, vendore dhe subjektet fizik dhe juridik.

**Dokumentat që aplikanti për Punonjës Mbështetës në Terren duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) të noterizuara(*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);
5. Raport mjeko – ligjor;
6. Dëshmi penaliteti;

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 20.10.2022 **ora: 16.30**